



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT Adresa/Adresa: Centralno Arhivo - Central Archive	
Nr./Br./No.	2323
Nr. i fq. të Str./No. pg.	5
Data/Datum/Date:	15.06.2023
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada - Government**

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja**  
**Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

**Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,**

Në mbështetje të nenit 3, dhe 24 të Ligjit Nr.2004/13 për Materialin Fidanor, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 22/ 01 Mars 2008), nenit 8 nën paragrafi 1.4 të Rregullores (QRK) – NR.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (31.03.2021), si dhe nenit 38 paragrafi 6 të Rregullores Nr.09/2011 për Punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr.15, 12.09.2011),

Nxjerrë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR) - NR. 03/2023 PËR REGJISTRIMIN,  
LICENCIMIN DHE CAKTIMIN E TAKSËS PËR PRODHUESIT E MATERIALIT  
FIDANOR**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kushtet për regjistrimin dhe caktimin e taksës për licencimin e prodhuesve të materialit fidanor.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij Udhëzimit Administrativ janë të detyrueshme për mënyrën e regjistrimit dhe caktimit të taksës për licencimin e prodhuesve të materialit fidanor.

**Neni 3**  
**Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin e njëjtë sikur në Ligjin Nr.2004/13 për Materialin Fidanor.

## Neni 4 Kushtet

1. Personat juridik që merren me prodhimin e materialit fidanor duhet të aplikojnë tek Autoriteti kompetent përgjegjës – Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregjeve në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

2. Personat që pajisen me licencë për prodhuesit e materialit fidanor të **pemëve** duhet t'i plotësojë kushtet si në vijim:

2.1. Të plotësojë kërkesën për Licencë;

2.2. Kopjen e certifikatës mbi regjistrimin e biznesit dhe informatat mbi biznesin me kodin përkatës të lëshuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK);

2.3. Raporti për analizat fiziko-kimike të tokës - *origjinal nga IBK ose nga laboratorë tjerë të akredituar – për fidane të pemëve.*

2.4. Të ketë të punësuar personin, me përgatitje profesionale që e dëshmon me diplomë të Fakultetit të Bujqësisë – drejtimi përkatës - kopje;

2.5. Deklaratën mbi prejardhjen e materialit për shumim -nënshartesa dhe mbishartesa - origjinal;

2.6. Procesverbali nga inspektori fitosanitar që dëshmon se posedon fidanishten për prodhimin e materialit fidanor të pemëve - origjinal;

2.7. Dëshminë mbi pagesën e taksës për Licencë.

3. Personat që pajisen me licencë për prodhuesit e materialit fidanor të **hardhisë së rrushit** duhet t'i plotësojnë kushtet si në vijim:

3.1. Të plotësojë kërkesën për Licencë;

3.2. Kopjen e certifikatës mbi regjistrimin e biznesit dhe informatave mbi biznesin me kodin përkatës të lëshuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK);

3.3. Raporti për analiza paraprake të tokës - *origjinal nga IBK ose nga laboratorë tjerë të akredituar – për fidane të hardhisë së rrushit;*

3.4. Të ketë të punësuar personin, me përgatitje profesionale që e dëshmon me diplomë të Fakultetit të Bujqësisë – drejtimi përkatës - kopje;

3.5. Deklaratën mbi prejardhjen e materialit për shumim - nënshartesa dhe mbishartesa - origjinal;

3.6. Procesverbali nga inspektori fitosanitar që dëshmon se posedon fidanishten për prodhimin e materialit fidanor të hardhisë së rrushit - origjinal;

- 3.7. Dëshminë mbi pagesën e taksës për Licencë.
4. Personat që pajisen me licencë për prodhimin e materialit fidanor të **bimëve dekorative** duhet t'i plotësojë kushtet si në vijim:
- 4.1. Të plotësojë kërkesën për Licencë;
  - 4.2. Kopjen e certifikatës mbi regjistrimin e biznesit dhe informatave mbi biznesin me kodin përkatës të lëshuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK);
  - 4.3. Të ketë të punësuar personin, me përgatitje profesionale që e dëshmon me diplomë të Fakultetit të Bujqësisë – drejtimi përkatës - kopje;
  - 4.4. Procesverbali nga inspektori fitosanitar që dëshmon se posedon fidanishten për prodhimin e materialit fidanor të bimëve dekorative - origjinal;
  - 4.5. Dëshminë mbi pagesën e taksës për Licencë.
5. Personat që pajisen me licencë për prodhimin e materialit fidanor të **perimeve** duhet t'i plotësojë kushtet si në vijim:
- 5.1. Të plotësojë kërkesën për Licencë;
  - 5.2. Kopjen e certifikatës mbi regjistrimin e biznesit dhe informatave mbi biznesin me kodin përkatës të lëshuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK);
  - 5.3. Të ketë të punësuar personin me përgatitje profesionale që e dëshmon me diplomë të Fakultetit të Bujqësisë – drejtimi përkatës - kopje;
  - 5.4. Procesverbali nga inspektori fitosanitar që dëshmon se posedon fidanishten për prodhimin e materialit fidanor të perimeve - origjinal;
  - 5.5. Dëshminë mbi pagesën e taksës për Licencë.

## **Neni 5 Kompensimi**

1. Për licencim aplikuesit paguajnë taksën:
- 1.1. Lartësia e taksës për Licencë për prodhuesit e materialit fidanor të **pemëve** paguhet në vlerë prej 30 €;
  - 1.2. Lartësia e taksës për Licencë për prodhuesit e materialit fidanor të **hardhisë së rrushit** paguhet në vlerë prej 30 €;
  - 1.3. Lartësia e taksës për Licencë për prodhuesit e materialit fidanor të **bimëve dekorative** paguhet në vlerë prej 30 €;

1.4. Lartësia e taksës për Licencë për prodhuesit e materialit fidanor të perimeve paguhet në vlerë prej 30 €.

#### **Neni 6 Licenca**

1. Autoriteti kompetent gjegjësisht DPB&T aplikuesit ja lëshon licencën në formë të shkruar.
2. Në rast kur dokumentacioni nuk është i kompletuar, atëherë kërkesa refuzohet dhe palës i jepet afat prej tetë (8) ditësh për kompletimin e dokumentacionit. Në rast se aplikuesi nuk mund ta bëjë kompletimin e dokumentacionit në afatin shtesë atëherë kërkesa i refuzohet.

#### **Neni 7 Lëshimi i licencës**

Autoriteti kompetent është i obliguar të lëshoi licencën, më së largu mbrenda afatit prej 15 ditë kalendarike nga dita e aplikimit gjegjësisht kompletimit të dokumentacionit. Në rast se personi i licencuar për prodhimin e materialit fidanor vepron në kundërshtim me kriteret e përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ, Autoriteti kompetent mund ta pezullojë apo anulojë licencën.

#### **Neni 8 Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e licencës së lëshuar nga Autoriteti kompetent – DPB&T është tre (3) vite.

#### **Neni 9 Mbajtja e shënimeve**

Personat që merren me prodhimin e materialit fidanor janë të obliguar të mbajnë shënime për përdorimin e pesticideve për mbrojtjen e materialit fidanor nga sëmundjet dhe dëmtuesit.

#### **Neni 10**

Të gjitha të hyrat që rrjedhin nga zbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

#### **Neni 11 Moszbatimi**

Moszbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ, sanksionohet me ndëshkimet e përcaktuara me nenin 2 të Ligjit Nr.08/L-085 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/13 për Materialin Fidanor.

#### **Neni 12 Dispozitat Shfuqizuese**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohen:

1.1. Udhëzimi Administrativ Nr.12/2004 për Regjistrimin e Prodhuesve të Materialit Fidanor të datës 30/09/2004;

1.2. Udhëzimi Administrativ MA - Nr.03/2007 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MA-NR.12/2004 për Regjistrimin e Materialit Fidanor të datës 14/03/2007; si dhe

1.3. Udhëzimi Administrativ Nr.03/2011 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MA - NR.03/2007 për Regjistrimin e Materialit Fidanor të datës 29/04/2011.

**Neni 13**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

 **Faton PEÇI**  
Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

15/06/2023